

Nocioni i zbërthimit semantik të fjalive

Mr. Agim Spahiu

13 prill 2003

Përmbledhje

Në këtë shkrim në pika të shkurtëra janë vënë në dukje konturat më themelore të zbërthimit semantik (me disa shembuj për ilustrim), kundruall atij formal- gramatikor e funksional që shtjellohet në gramatikat tona shkollore e universitare.

Në gramatikat e gjuhës shqipe ky lloj zbërthimi është lënë pas dore, ngase vëmendje e veçantë i është kushtuar kryesisht analizës formale- sintaksore. Ndërkaq, në gjuhët e tjera, e në mënyrë të veçantë në gjuhën gjermane, krahas shpjegimit dhe zbërthimit të njëjësive sintaksore- kumtuese, flitet edhe për zbërthimin semantik të tyre (gjer. *Semantische Satzmodelle*).

Dallimi në mes zbërthimit të parë të fjalive dhe të dytës qëndron në sa vijon:

Derisa në analizën formale- gramatikore çdo trajtë nominale e përdorur në rasën emërore konsiderohet kryefjalë, në analizë për të cilën po bëjmë fjalë, këto trajta konsiderohen si: **agensa, kausator, instrumental** etj. Këtu del se trajtat e fundit vështrohen vetëm nga aspekti kuptimor i tyre. Sa për sqarim po sjellim disa shembuj:

1. **Ai thyen gotat;**
2. **Termeti lëviz shtëpinë;** dhe
3. **Makina mbush shishet**

Në të tri rastet trajtat: *Ai, Termeti dhe Makina*, në analizën formalo-gramatikore konsiderohen kryefjalë të fjalive, sepse janë përdorur në rasën emërore. Kurse në analizën semantike, në fjalinë e parë (Ai) konsiderohet *agens*, në të dytën (Termeti) *kausator*, ndërsa në të tretën (Makina) *instrumental*.

E njëjta gjë vlen edhe për kundrinat: Derisa një trajtë çfarëdo, që përdoret në rasën kallëzore, në analizën formale- gramatikore konsiderohet kundrinë e drejtë dhe e zhdrejtë, në analizën semantike ajo mund të dalë si *patiens* (fjalët: shtëpinë, shishet në fjalinë e dytë dhe të tretë), si *rezultativ*, (fjala ëmbëlsira në fjalinë: Ajo gatuan ëmbëlsira, si *lokativ* (fjala sallën në fjalinë: Ai e rregullon sallën), si *adresat* (togfjalëshi nënën e vet në fjalinë: Ai e ndihmon nënën e vet)etj.

Në këtë analizë semantike mund të ndeshim terma të ndryshëm në gjedhet e ndryshme strukturore të fjalive si: *agens + predikat*, si në fjalinë: Ai punon; *Instrument + predikat*

+ *patiens* në fjalinë: Thika pret bukën; *agens + predikat + patiens + instrument*, në fjalinë: Ai e pret bukën me thikë; *patiens + predikat*, në fjalinë: Ushqimi zihet; *agens + predikat*, në fjalinë: *causus + predikat + patiens*, në fjalinë: Uji ka vërshuar shtëpinë; *agens + predikat + instrumental + lokativ*, si në fjalinë: Ai udhëton me tren për në Dresden; etj.

Kjo terminologji gjuhësore, siç del edhe nga shembujt, lidhet ngushtë me semantikën e secilës fjalë veç e veç.

Shumica e këtyre termave e kanë prejardhjen nga gjuha latine, por në gjuhën tonë mund të mbulohen me disa fjalë të tjera përgjegjëse, si p. sh.: Agensi= **Vepruesi**= lokativi= **vendorja**; patiens= **pësuesi**; instrumentali= **mjeti**; adresati= **drejtuesi**; kausus= **shkaku/shkaktari**; rezultativ= **rezultati**; etj.